



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organ Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 637/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Kimete Gashi–Kryetare, Vjosa Gradinaj Mexhuani- Anëtare, Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik “Roza Komani B.I (NNSH Korben)” Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “NDËRTIMI DHE SANIMI1 PARQEVE”, me numër të prokurimit: 632-22-4421-5-2-1, iniciuar nga AK-Kuvendi Komunal Gjakovë, me datën 27.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. **HEDHET** si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik “Roza Komani B.I (NNSH Korben)” Gjakovë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 08.11.2022 me numër të protokollit 637/2022, për aktivitetin e prokurimit: “NDËRTIMI DHE SANIMI1 PARQEVE”, me numër të prokurimit: 632-22-4421-5-2-1, iniciuar nga AK-Kuvendi Komunal Gjakovë. Kurse Vendimi i AK lidhur me aktivitetin prokurimit mbetet në fuqi i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij Vendimi.

II. Me qenë se ankesa e për OE “Roza Komani B.I (NNSH Korben)” Gjakovë”, hedhet si e palejuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me 26.10.2022, Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal Gjakovë, ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “NDËRTIMI DHE SANIMI1 PARQEVE”, me numër të prokurimit: 632-22-4421-5-2-1, iniciuar nga AK-Kuvendi Komunal Gjakovë.

Me datën 31.10.2022 OE ankues “Roza Komani B.I (NNSH Korben)” Gjakovë” ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim me vendim të datës 03.11.2022.

Me 08.11.2022 OE “Roza Komani B.I (NNSH Korben)” Gjakovë”, ka parashtuar ankesë me (Nr. protokolli: 637/22), kundër njoftimit për dhënie të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 24.11.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Ankesa e OE të refuzohet si e pabazuar;

Mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit;

Eksperti shqyrtues, ka shqyrtuar pretendimin ankimor në ankesën e OE ankues “Roza Komani B.I (NNSH Korben)”Gjakovë. Andaj, duke u bazuar në faktet e prezantuara në dokumentacionin e publikuar në Platformën e Prokurimit Elektronik, konstaton si ne vijim:

Autoriteti Kontraktues respektivisht komisioni vlerësues i ofertave, pas Ri-vlerësimit të ofertave ka rekomanduar për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik “Lulzim Beqiraj B.L;FIDANI-BETON” SH.P.K

Vlen të theksohet se, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë, komisioni vlerësues ka konsideruar se në oferta e OE të rekomanduar është jo-normalisht e ulët rrjedhimisht me datë 30.06.2022. AK i ka dërguar Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, duke kërkuar nga OË i rekomanduar me shkrim një deklaratë të nënshkruar, vulosur dhe duke zbërthyer në mënyrë të detajuar kalkulimin e çmimit të paraqitur në ofertë.

Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konsideron se, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 4, Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, sepse Qëllimi i këtyre Rregullave është që të jepen sqarime për Autoritetet Kontraktuese në lidhje me Konceptin e tenderit jo-normalisht të ulët.

Paragrafi 1 i neni 61 të LPP-së përcakton:

“1.Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni”. Gjithashtu, Neni 4.2 i Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, përcakton:“4.2 Në rast se një tender(apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ulët, një deklaratë me shkrim e cila përfshin një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegon për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja “Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët”.”

Eksperti shqyrtues konsideron se, në rastin konkret, është fakt se disa pozicione vërtetë janë çmime jo- normalisht të ulëta dhe nën vlerën mesatare të tregut, por meqenëse kriter i vlerësimit ka qenë çmimi më i ulët me Peshim, Autoriteti Kontraktues respektivisht komisioni vlerësues ka vepruar në pajtim e nenin 61 të LPP- së dhe nenin 4, Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulet.

Për faktin se, sipas nenit 29.4 të Rregullores për Prokurim Publik, e cila përcakton si në vijim: 29.4 Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës, ndërsa të kontrata me çmim për njësi apo me poentim kërkohet 10% e vlerës së parashikuar. Kur përcaktohet përqindja e sigurimit të ekzekutimit, në rast të kontratave me vlerë të mesme ose të madhe, AK do të siguroj që përqindja mjafton për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata. Autoriteti kontraktues, pasi që të jetë përputhur me nenin 61 të LPP-se, ka mjaft arsye për të besuar se Operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht të ulët), gëzon të drejtën që përqindjen e kërkuar të sigurimit të ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata”.

Eksperti Shqyrtues konstaton se, OE ankues “Roza Komani BJ (NNSH Korben)”Gjakovë, mund të konsiderohet si palë pa interes, duke qenë se, edhe nëse aktiviteti i prokurimit kthehet në Ri-

vlerësim pretendimet e OE ankues janë vetëm për OE të rekomanduar, kështu që, sipas komisionit vlerësues janë edhe tri oferta (OE të përgjegjshëm por të pasuksesshëm) të cilët rezultojë me ofertën më të lirë në raport me OE ankues.

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE "Roza Komani B.I (NNSH Korben)" Gjakovë të refuzohet si e Pabazuar, rrjedhimisht i propozon Panelit Shqyrtues të OSHP-së të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Duke u bazuar në nenin 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritë të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët pohimet, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij lidhur me operatorin ekonomik ankues mund të konsiderohet si palë pa interes, duke qene se, edhe nëse aktiviteti i prokurimit kthehet në Ri-vlerësim pretendimet e tije janë vetëm për OE të rekomanduar, kështu që, sipas komisionit vlerësues janë edhe tri oferta (OE të përgjegjshëm por të pasuksesshëm) të cilët rezultojë me ofertën më të lirë në raport me OE ankues, janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuese e Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Kuvendi Komunal Gjakovë;

1x1 OE - "Roza Komani B.I (NNSH Korben)" Gjakovë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.